



AKT THEMELIMI I SHOQËRISË AKSIONARE
"KLUBI I FUTBOLLIT TIRANA" SH.A.

Sot me datë 12/10/2011, përpara meje Laura Pustina, notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në Rr. Abdyl Frashëri, nr .31, Tiranë u paraqit me cilësinë e aksionarit themelues:

Bashkia Tiranë, e përfaqësuar nga Kryetari i saj z. Lulzim Basha, shtetas shqiptar, i datëlindjes 12/06/1974, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë e juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. H40642062J i cili ka vendosur krijimin e shoqërisë "Klubi i Futbollit Tiranë" SH.A. me termat e mëposhtëm:

NENI 1

Të themelojë Shoqërinë Tregtare "Klubi i Futbollit Tiranë" SH.A., në formën e një Shoqërie Aksionare me ofertë private. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë Shoqëria kundrejt të tregteve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shenohet detyrimisht emri "Klubi i Futbollit Tiranë" SH.A., sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit sportiv futboll, rritja e vlerave sportive për sportin e futbollit, duke zbuluar elementët të talentuar dhe përgatitja e tyre për të ardhmen e sportit në përgjithësi. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri, logo dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullim juridiko – civil me emrin "Klubi i Futbollit Tiranë" SH.A. Ajo do të ketë logon dhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit.

Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit, dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Futja në tregun e lojtarëve për të blerë dhe shitur lojtarë sipas nevojave të ekipit.

Aktivitetet të tjera në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë dhe Bashkisë.

Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj.

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licencat apo lejet përkatëse.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe afati i veprimtarisë

Selia e Shoqërisë do të jetë në Stadiumin "Selman Stermasi". Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të përcaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 6.445.263.000 (gjashtë miliard e katerqind e dyzet e pese milion e dyqind e gjashtedhjetë e tre mije) lekë.

Ai është i ndarë, në 6.445.263 (gjashtë milion e katerqind e dyzet e pese mijë e dyqind e gjashtedhjetë e tre) aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 1000 (një mije) lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre. Aksionet janë të numëruara nga 1 deri në 6.445.263 (gjashtë milion e katerqind e dyzet e pese mijë e dyqind e gjashtedhjetë e tre) aksione.

Aksionet të themelues të Shoqërisë "Klubi i Futbollit Tiranë" SH.A. zotërojnë aksionet në këtë Shoqëri si më poshtë:

Bashkia e Tiranës, zotëron 100% të vlerës së aksioneve në kapitalin themeltar të shoqërisë të barabartë me 6.445.263 (gjashtë milion e katerqind e dyzet e pese mijë e dyqind e gjashtedhjetë e tre) numër aksionesh, me vlerë 1000 (një mije) lekë lekë.

NENI 7

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para dhe/ose në natyrë i aksionarëve themelues të kësaj Shoqërie.

NENI 8

Organet drejtuese

Duke iu referuar ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve-organi më i lartë i vendimmarrjes;

Këshilli mbikëqyrës-organ i mbikëqyrjes;

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

NENI 9

Këshilli Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët janë caktuar si më poshtë:

Z. Marenglen Shyti, shtetas shqiptar, i datëlindjes 10/01/1981 lindur në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit/pasaportës me nr. I10110119A;

Z. Artan Pogoni, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20/03/1972 lindur në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit/pasaportës me nr. BJ8237772;

Z. Luigj Bytyçi, shtetas shqiptar, i datëlindjes 11/04/1940, lindur në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit/pasaportës me nr. 024543067;

Znj. Dhurata Çupi, shtetase shqiptare, i datëlindjes 21/04/1973, lindur në Mat, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit/pasaportës me nr 024388223;

Z. Fatmir Frashëri, shtetas shqiptar, i datëlindjes 03/04/1941 lindur në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit/pasaportës me nr 024744487;

Z. Enver Reçi, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29/12/1949 lindur në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit/pasaportës me nr. E91229015G;

Z. Indrit Fortuzi, shtetas shqiptar, i datëlindjes 23/11/1973, lindur në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit/pasaportës me nr. 026062096;

Z. Sulejman Mema, shtetas shqiptar, i datëlindjes 17/11/1955, lindur në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit/pasaportës me nr. F51117057H;

Z. Krenar Alimhmeti, shtetas shqiptar, i datëlindjes 15/01/1966, lindur në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit/pasaportës me nr. 024759089;

Kohëzgjatja e anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës do të jetë tre vjet. Ata kanë të drejtë të zgjidhen.

NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga administratori i cili zgjidhet për një afat 3-vjeçar.

Administratori i parë i shoqërisë "Klubi i Futbollit Tiranë" SH.A. është z. Lulzim Basha, shtetas shqiptar, i datëlindjes 12/06/1974 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori i dytë i shoqërisë "Klubi i Futbollit Tiranë" SH.A. është z. Alban Tafaj, shtetas shqiptar, i datëlindjes 03/12/1971, lindur në Tiranë, dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrdhënie me të tretët nga Administratori i saj i parë z. Lulzim Basha dhe/ose Administratori i dytë z. Alban Tafaj, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Aksionari themelues mund të vendosë me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, përveçse atij që mund të jetë konkurreues me atë të shoqërisë "Klubi i Futbollit Tiranë" SH.A.

NENI 13

Mosmarrëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me përfundim të përfundim të themelues dhe, kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u gjet sipas vullnetit të përfaqësuesit të bashkëthemeluesve dhe nënshkrua pa vërejtje nga ana e tyre para noterit të vendit të themelimit.

Ky akt Themelimi hartohet në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

AKSIONARI I VETËM I SHOQËRISË TREGTARE
"KLUBI I FUTBOLLIT TIRANA" SH.A.
BASHKIA E TIRANËS

E përfaqësuar nga:

Kryetari

Lulzim Basha
Lulzim Basha

NOTERE
Laura Pustina



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 14, datë 12.10.2011

PËR
"TRANSFORMIMIN NË SHOQËRI AKSIONARE TË KLUBIT TË
FUTBOLLIT TIRANA, MIRATIMIN E AKTIT TË THEMELIT DHE
STATUTIT TË SHOQËRISË AKSIONARE "KLUBI I FUTBOLLIT
TIRANA"

Mbështetur në nenet 7/2, 8/1/II/a) e "c", 10/3/II/b", 32/d) dhe 44/b) e "c" të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" (i ndryshuar); nenin 19 të ligjit nr.9376, datë 21.04.2005 për "Sportin" (i ndryshuar); ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare"; nenin 27 të ligjit nr.9879, datë 21.02.2008 për "Titujt"; nenin 26, 28, 32, 36, 43, 45 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; ligji nr.9228, datë 29.04.2004 për "Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Kodi Civil; VKM-së nr.1718, datë 24.12.2008 për "Procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar"; VKM-së nr.794, datë 21.11.2007 për "Kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes"(e ndryshuar); Udhëzimit të përbashkët nr.8758/1 prot., datë 25.10.2010 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës si dhe nr.7066 prot., datë 01.10.2010 të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për "Zbatimin e VKM-së nr.1718, datë 24.12.2008 për "Procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar", me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë "Klubi i Futbollit Tiranë" SH.A., në kuadër të transformimit në shoqëri aksionare të Klubit të Futbollit Tiranë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Klubi i Futbollit Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI

Niazi Kosovra